



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400956/8

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë dhënien e masës së plotë të pensionit të pleqërisë shtetasit Sh.B që nga data e ndërprerjes së pensionit e në vijimësi, me qëllim rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur.*

Drejtuar: **Znj. Miranda KOKA**
Drejtoreshë e Drejtorisë Rajonale
të Sigurimeve Shoqërore

D U R R Ë S

Siç jeni në dijeni, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi *Sh. B*, në përmbajtjen e së cilës ankohet për mospërfitim e plotë të masës së pensionit të pleqërisë.

Aktualisht ankuesi përfiton 50% të masës së pensionit të pleqërisë.

Për nevojat e shqyrtimit të kësaj ankesë, fillimisht kemi kërkuar shpjegime pranë institucionit tuaj, duke ju kërkuar edhe kopje të urdhërit të ndërprerjes së pensionit të pleqërisë së shtetasit *Sh. B*.

Me shkresën nr.5960/1 datë 01.09.2014, na informoni si më poshtë:

"Në zbatim të vendimit gjyqësor dhe Urdhër Akzekutimit është rishqyrtuar data e fillimit të pensionit të z.Sh.B. Nga rishqyrtimi rezulton se duhet të merret diferenca nga 25.04.2000-11.04.2008 në shumën 374.040 lekë.

Në Bankën Kombëtare Tregtare Durrës nga llogaria e DRSSH, Durrës, z. Sh.B, nëpërmjet zyrës përmbartimore ka tërhequr padrejtësisht shumën 954.128 lekë.

Për sa më sipër rezulton të jetë debitor ndaj DRSSH Durrës në shumën 580.088 lekë. Për këtë arsye pensioni u pezullua derisa të shlyente këtë shumë.

Me vendimin nr. 185/1 datë 13.12.2013 është marrë edhe një herë dosja për rishqyrtim dhe rezulton se nga shuma debitore i kishin mbetur 356.272 lekë për të shlyer.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të shlyer këtë shumë i mbahen 50% të masës së pensionit (6012 lekë në muaj) nga 01.12.2013-30.04.2019.

Kur të shlyej të gjithë shumën debitore ndaj Sigurimeve Shoqërore Durrës, shtetasi Sh. , do të marrë masën e plotë të pensionit.”

Nga trajtimi i kësaj praktike administrative, bazuar në kthimin e përgjigjes suaj, në shpjegimet e marra nga ankuesi si dhe dokumentacionin që ne disponojmë, rezulton se:

Për njohjen e vjetërsisë në punë, ka ndjekur rrugën gjyqësore. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 11-2010-906 (564) datë 03.03.2010 ka vendosur pranimin e padisë së paditësit Sh.B si edhe detyrimin e palës së paditur, DRSSH Durrës t'i lidhë pension paditësit si në marrëdhënie pune me shtetin, duke e përfituar atë që nga momenti që i ka lindur e drejta.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 11-2011-495 (260) datë 11.04.2011.

Pas marrjes së këtij vendimi, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Shërbimit Përmbarrimor Privat “Best 2010”.

Përmbarruesi gjyqësor, ka vijuar procedurat përkatëse për ekzekutimin e vendimit të sipërcituar dhe në fund të veprimeve, ka marrë vendimin për pushimin e ekzekutimit. Konkretisht:

- Të pushoj ekzekutimin për titullin ekzekutiv të përcaktuar në urdhërin e Ekzekutimit nr. 2827 datë 13.06.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës, pasi detyrimi është shlyer plotësisht.
- Të mbyll dosjen përmbarrimore dhe ta arshivoj atë pranë kësaj zyre përmbarrimore.
- Ky vendim i njoftohet palëve që kanë të drejtë të kundërshtojnë pranë kësaj zyre përmbarrimi ose në Gjykatë, sipas rregullave të përcaktuara në K.Pr.Civile.

Institucioni i juaj ka kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës kundërshtimin e veprimeve përmbarrimore.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.11-2012-7518 (2629) datë 16.10.2012, ka vendosur:

“-Rrëzimin e kërkesë-padisë së palës paditëse Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës, me të paditur Zyra Përmbarrimore “Best 2010”, me person të tretë Shfaqet Barushi dhe me objekt:

-Kundërshtim e veprimeve përmbarrimore. Anulimim e vendimit nr.168/4 datë 09.08.2012.....”

Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr.10-2013-1637(745) datë 05.11.2013 të Gjykatës së Apelit Durrës.

Zonja Koka,

Avokati i Popullit çmon se, institucioni që Ju drejtoni, duhet të zbatojë vendimin gjyqësor dhe të procedojë me një kërkesë padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me paditës z.Sh.B, për përfitim të padrejtë të shumës prej 580.088 lekëve dhe të procedojë pas marrjes së vendimit dhe jo të nxjerrë urdhër për ndërprerjen e pensionit të pleqërisë dhe dhënien e pensionit të pleqërisë në masën 50%.

Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 142 të saj, pika 3, ka përcaktuar se:
“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.”.
Kodi i Procedurës Civile në dispozitat e tij të përgjithshme për titujt ekzekutiv, në nenin 510 të tij, ka përcaktuar se:

“...Janë tituj ekzekutiv:

a) *Vendimet civile të formës së prerë të Gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet.....”.*

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues që luan një rol të rëndësishëm në kuadër të mbrojtjes të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve, të respektimit të shtetit të së drejtës dhe për të gjitha arsyet dhe konstatimet e përmëndura më lart, në mbështetje në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se:
“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se : “Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

Dhënien e masës së plotë të pensionit të pleqërisë shtetasit Sh.B që nga data e ndërprerjes së pensionit e në vijimësi, me qëllim rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet shprehimisht se: “Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI